



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE

DREJTORIA E PROKURIMEVE

Dt. [02.08.2023]

## FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

**(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

**BOE “Tok Digital Agency” sh.p.k & “Adriatica RC” sh.p.k**

**Adresa:** Tirane Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Kati 6

Procedura e prokurimit/lotit: **Procedurë e hapur.**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: Përshkrimi i shkurtër i kontratës: *[Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]* **“Programi i nxitjes dhe rritjes së kapaciteteve të rinjve në fushën e teknologjisë dhe inovacionit” me Nr. reference REF-66335-04-18-2023** për nevoja të Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë.

Publikimet e mëparshme (*Njoftimi i kontrates*): Buletini Nr. 36 datë 24 Prill 2023

Publikimet e mëparshme (*Njoftimi i fituesit paraprak*): Buletini Nr. 47 datë 29 Maj 2023

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara.

- **Bashkimi i Operatorëve ekonomik “PIK” sh.p.k, -L12316016A dhe “OPTIMA COMMUNICATION” sh.p.k- K71903025A**

Vlera e ofertës pa tvsh = 14.917.000 (katërbëdhjetë milion e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) lekë.

- **BOE “Tok Digital Agency” sh.p.k - L62126009T dhe “Adriatica RC” sh.p.k – M01506035F**

Vlera e ofertës pa tvsh = 16,250,600 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë.

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

- **Bashkimi i Operatorëve ekonomik “PIK” sh.p.k, -L12316016A dhe “OPTIMA COMMUNICATION” sh.p.k- K71903025A**

Për arsyet e mëposhtme:

- I. Autoriteti Kontraktor, në pikën 2.3.1 të Kapacitetit teknik pjesë e “Kritereve të vecanta të kualifikimit kërkon:

*“2.3.1 Për të provuar përvojën e mëparshme, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 7.323.806,66 (shtatë milion e treqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e gjashtë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:*

*a) Si dëshmi për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.*

*b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.”*

Në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri, nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në s.p.e e konkretisht nga verifikimi i Kontratës së bashkëpunimit të përkohshme të BOE “PIK” sh.p.k dhe “OPTIMA COMMUNICATION” sh.p.k, rezulton se secili prej anëtarëve të BOE ka marrë përsipër të realizojë zërat:

Nr.	Shërbimi	Përshkrimi i shërbimit	Njësia	Sasia	Operatori përgjegjës
1	(FAZA II dhe FAZA III e ToRS) Fushata komunikimi brandimi dhe Organizimi i	1.1 Mockup sipas termave të referencës	shërbim	1	Optima Communication sh.p.k..
		1.2 Spila	copë	1000	Optima Communication sh.p.k.

takimeve e trajnimeve	1.3 Silolapsa	copë	1000	Optima Communication sh.p.k.	
	1.4 Tote bags	copë	1000	Optima Communication sh.p.k.	
	1.5 Blloqe	copë	1000	Optima Communication sh.p.k.	
	1.6 Dosje të branduara	copë	1000	Optima Communication sh.p.k.	
	1.7 Certifikata	copë	1000	Optima Communication sh.p.k.	
	1.8 Banner i madh i printuar me përmasa 4 x 5 m me strukture	copë	1	Optima Communication sh.p.k.	
	1.9 Rollup të printuara të përmasave 85x200 cm	copë	4	Optima Communication sh.p.k..	
	1.10 Postera të branduara të përmasave A3	copë	15	Optima Communication sh.p.k.	
	1.11 Broshura të printuara të formatit A5	copë	1000	Optima Communication sh.p.k.	
	1.12 Shërbime transporti	shërbim	1	Pik sh.p.k.	
	1.13 NdërfaqeWeb	shërbim	1	Pik sh.p.k.	
	1.14 Shërbime të tjera	shërbim	1	Pik sh.p.k.	
	2 (FAZA IV dhe FAZA V e ToRS) Organizimi i mini-konkurseve në	2.1 Katering banket për (70 x11) persona , përfshirë personel shërbyes	shërbim	1	Pik sh.p.k.

	gjimnaze, Inkubimi dhe mentorimi i ideve	2.2 Shërbim fotografie, fonie, projektor	shërbim	1	Pik sh.p.k.
		2.3 Shërbime të tjera	shërbim	1	Pik sh.p.k.
3	(FAZA VI e ToRS) Konkursi Startup	3.1 Katering banquet për 130 persona, përfshirë personel shërbimi	shërbim	1	Pik sh.p.k.
		3.2 Shërbim kafe për 130 persona, përfshirë personel shërbimi	shërbim	1	Pik sh.p.k.
		3.3 Shërbim fotografie dhe videomontimi , Foni, LED wall.	shërbim	1	Pik sh.p.k.
		3.4 Shërbime të tjera	shërbim	1	Pik sh.p.k.
4	(FAZA VII e ToRS) Organizimi i festivalit përmbyllës	4.1 Katering banquet për 130 persona, përfshirë personel shërbyes	shërbim	1	Pik sh.p.k.
		<b>4.2 Shërbim fotografie dhe videomontimi, foni, LED ëall</b>	<b>shërbim</b>	<b>1</b>	
		4.3 Shërbime të tjera	shërbim	1	Pik sh.p.k.
5	Tablet		copë	35	Optima Communication sh.p.k.
6	Laptop		copë	5	Optima Communication sh.p.k.

Referuar sa më sipër, Operatori Ekonomik “PIK” sh.k.p ka marrë përsipër të realizojë zërat “Shërbime të tjera” 1.14, 2.3 dhe 4.3 të tabelës “Planifikimi i Buxhetit”, ku sipas termave të referencës pjesën kryesore të tyre e zë kryerja e shërbimeve:

- *Seanca trajnuese përpara realizimit të minikonkurseve.*
- *Procese inkubimi/këshillimi/trajnimi i cili do të zhvillohet në bashkëpunim me mentorë dhe profesionistë të fushës së sipërmarrjes dhe TIK.*
- *Aftësimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të të rinjve.*
- *Hartimi një studimi ku janë identifikuar dhe propozuar zgjidhje për problemet e hasura.*

Operatori Ekonomik “PIK” sh.k.p nuk ka paraqitur asnjë dëshmi për të provuar përvojën e mëparshme (sipas kërkesave të kriterit 2.3.1 të dokumentave standarde të tenderit), të ngjashme me shërbimet e sipërcituara. të cilat janë thelbësore në realizimin e programit të nxitjes dhe

rritjes së kapaciteteve..., duke sjellë kështu pasiguri dhe risks serioz për implementimin e një kontratë të sukseshme.

**Referuar sa më sipër, KVO gjykon se operatori ekonomik BOE “PIK” sh.p.k dhe “Optima Communication” sh.p.k nuk përmbush kërkesat e kriterit 2.3.1 të Kapacitetit Teknik të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit (shtojca 8 ) e DST.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 92 pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin publik” dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(i ndryshuar), Neni 82 pika 2, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **BOE “Tok Digital Agency” sh.p.k - L62126009T dhe “Adriatica RC” sh.p.k – M01506035F**, me adresë: Tirane Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasherit, EGT Tower, Kati 6, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 16,250,600 (gjashtëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind) lekë pa tvsh është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *Autoritetit Kontraktor Bashkia Tiranë me adresë Blv “Dëshmorët e Kombit”, Tiranë* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60(gjashtwdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) Vendim KPP Nr 661/2023 dt 24.07.2023.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) \_\_\_\_\_